

VENDIM
Nr. 334, datë 2.6.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, VORË, SHIJAK
DHE MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 423 870 160 (katërqind e njëzet e tre milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Durrës, Kamzë, Vorë, Shijak dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 127 823 334 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi në masën 95 200 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë e dyqind mijë) lekë;

c) Bashkisë Vorë i transferohet fondi në masën 47 080 850 (dyzet e shtatë milionë e tetëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë;

ç) Bashkisë Shijak i transferohet fondi në masën 80 410 770 (tetëdhjetë milionë e katërqind e dhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë;

d) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi në masën 73 355 206 (shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtë) lekë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet:

a) Në masën 300 000 000 (treqind milionë) lekë nga gjendja e pashpërndarë e granteve/donacioneve të rindërtimit, përkatësisht, për:

i. Bashkinë Durrës në masën 127 823 334 (njëqind e njëzet e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë;

ii. Bashkinë Kamzë në masën 95 200 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë e dyqind mijë) lekë;

iii. Bashkinë Vorë në masën 47 080 850 (dyzet e shtatë milionë e tetëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë;

iv. Bashkinë Shijak në masën 29 895 816 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

b) Në masën 123 870 160 (njëqind e njëzet e tre milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe iu transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar, përkatësisht, për:

i. Bashkinë Shijak, në masën 50 514 954 (pesëdhjetë milionë e pesëqind e katërmëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër) lekë;

ii. Bashkinë Mirditë, në masën 73 355 206 (shtatëdhjetë e tre milionë e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtë) lekë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Durrës, Kamzë, Vorë, Shijak dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe